



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 30.05.2023

Nr: 169

Ora: 16:20

**VENDIM**

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 90, DATË 26.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA KOALICIONI "BASHKË FITOJMË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 30.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Koalicioni "Bashkë Fitojmë"

**OBJEKT:** Kundërshtim i vendimit nr. 545, datë 23.05.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Lezhë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023".

**BAZË LIGJORE:** Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

### **VËREN:**

Subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 90 regj., datë 26.05.2023.

Në seancën e datës 29.05.2023 KAS konstatoi se kjo kërkesë ankimore nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta, duke qartësuar palës ankimuese se duhet të paraqesë provat bashkëlidhur dhe një përshkrim më të detajuar të fakteve dhe rrethanave konkrete.

Me anë të vendimit nr. 158, datë 29.05.2023, KAS vendosi kthimin e kërkesës ankimore për plotësim të elementeve të formës me një afat 24 orë, si dhe zhvillimin e seancës paraprake datë 30.05.2023, ora 16:20.

Në mbledhjen e datës 30.05.2023, ora 16:20, pas relatimit të z. Koli Bele u konstatua dhe u pohua nga administrata e KQZ-së se subjekti nuk e kishte ridepozituar kërkesën ankimore të korrigjuar.

Për këto arsye, duke qenë se kërkesa ankimore nuk është depozituar e korrigjuar, në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 90, datë 26.05.2023, të paraqitur nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot, më datë 30.05.2023

<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>